

STATUTI DHE AKTI I THEMELIMIT
I
SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“MM EUROPE” SHPK

Ky statut dhe akt i themelimit, Ligji nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” (i ndryshuar), Ligji Nr. 9723 "Për Regjistrimin e Biznesit", i ndryshuar, rregullojnë organizimin dhe funksionimin e shoqërisë tregtare me përgjegjësi të kufizuar “MM EUROPE” SHPK.

KREU I

Emri, Forma, Zyra Qendrore, Objekti i Veprimtarisë, Kohëzgjatja, Degët dhe Zyrat e Përfaqësimit, Përgjegjësia e Ortakut

NENI 1

Emri

1.1 Shoqëria tregtare mban emrin “MM EUROPE” SHPK.

1.2 Ndryshimi i emërimit të shoqërisë mund të bëhet vetëm me vendim të Ortakut të Vetëm të shoqërisë.

NENI 2

Forma

2.1 Shoqëria tregtare “MM EUROPE” SHPK, ka formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar.

NENI 3

Zyra Qendrore

3.1 Shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar “MM EUROPE” SHPK, e ka selinë në Shqipëri, Tiranë, Njesia bashkiake nr.5 Bulevardi Bajram Curri, Ndertesa nr.112, Hyrja nr.7, Apartamenti nr.4, Tirane (1022). Numri i telefonit +393296339558 dhe adresa e dhe adresë emaili: dr.farina@studiofarina.us

NENI 4

Objekti i Veprimtarisë

4.1 Kompania ka si qëllim të saj korporativ çdo operacion të ligjshëm tregtar që përfshin, por nuk kufizohet në, aktivitetet e renditura më poshtë:

Shërbime inxhinierike dhe arkitekturore si për punët publike ashtu edhe për ato private: konsulencë specialistike, studime fizibiliteti, tekniko-ekonomike, kerkim, planifikim dhemenaxhimin e puneve inxhinierike, përpunime grafike.



Shërbimet inxhinierike dhe arkitekturore të listuara më sipër do të mbulojnë fushat arkitekturore, strukturore, impiante, zjarri, mjedisore dhe peizazhore të të gjitha veprave civile, ushtarake, industriale dhe infrastrukturore.

Zhvillimi dhe ushtrimi i aktiviteteve teknike punimeve publike dhe private, konsulence të specilizuara që perkojnë me menaxhimin dhe kontrollin teknik dhe ekonomik, studime tregu për pasuritë e pa tundshme, studime mjedisore dhe industrial, mbështetje logjistike të aktiviteteve dhe organeve të inspektimit teknike ndertimeve civile, ushtarake, industrial dhe infrastukture.

Konsulence për dhenien e autorizimeve dhe plotësimin e praktikave mbi vlerësimet finale të impianteve për prodhimin, transformimin dhe përdorimin e energjisë nga burime të rinovueshme, analiza e bimeve mjedisore, analize e burimeve të ndryshme mjedisore që synojnë shfrytëzimin e burimeve të energjisë së rinovueshme dhe vlerësimin e ndikimit në mjedis.

Trasferimin teknologjik të kompanive të huaja. Konsulencë në mënyrën e organizimit të kantierëve dhe sigurinë në punë, problemet teknike – administrative dhe atyre civile. Konsulencë teknike dhe menaxheriale dhe të zyrave teknike civile të administratës publike brenda dhe jashtë vendit.

Aktivitete si studime tregu, eksperimente analitike, certifikime, homologime kolaudime dhe testime.

Krijime dhe menaxhime të kurseve profesionale në sektorin inxhinierik dhe ambientalist. Llogaritja dhe përpunimi i të dhënave. Për vec aktiviteteve të sipër përmendura në fushën e inxhinierisë mund të përfshihen në aktivitete të tjera shtesë ndihmëse, të ngjashme apo të lidhura në mënyrë direkte apo jo.

Konsulence imobiliare të pasurive të pa lujtshme, ndërmjetësime financiare, tregëtare dhe industriale të miratuara nga organi i asamblese së kompanisë. Shoqëria gjithashtu, mund të kryejë transaksione fodejusioni për llogari të paleve të treta.

Kompania ka të drejtë veprimi brenda dhe jashtë vendit.

Blerja, shitja dhe menaxhimi i pasurive të paluajtshme në pronësi dhe për llogari palët e treta;

Dhënia me qira (me përjashtim të qiradhënies aktive) të pronave në pronësi;

Kompania do të jetë në gjendje të sigurojë dhe drejtojë shërbimet dhe aktivitetet e saj në favor të çdo personi dhe midis tyre subjekteve, ndërmarrjeve, organeve publike dhe private, shoqërive, sipërmarrësve dhe jo-sipërmarrësve.

Për arritjen e objektivave të saj shoqëria mund të kryejë, kryesisht:

a) çdo operacion tregtar, industrial, financiar të pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme e konsideruar e nevojshme dhe e dobishme nga organi administrativ, përveç transaksioneve që mund të rrezikojnë pavarësinë e tij financiare;

b) të marrë direkt ose indirekt interesa ose kuota pjesëmarrje në shoqëri të tjera apo ndërmarrje me qëllim të ngjashëm apo të njëjtit tregtar por që gjithsesi të lidhur.

ENI 5

Kohëzgjatja

5.1 Kohëzgjatja e aktivitetit të shoqërisë “MM EUROPE ” SHPK do të jetë deri më 31 dhjetor 2091 dhe mund të zgjatet.

NENI 6

Degët dhe Zyrat e Përfaqësimit

6.1 Shoqëria tregtare “MM EUROPE ” SHPK mund të hapë degë të saj ose zyra përfaqësimi brenda ose jashtë vendit.

6.2 Mbledhja e Ortakeve, mund të vendosë, transferojë dhe/ose të mbyllë, si brenda edhe jashtë shtetit shqiptar, degë sekondare, filiale, seli, agjensi, zyra përfaqësimi dhe bashkësi lokale të çdo natyre.

NENI 7

Përgjegjësia e Ortakut

7.1 Ortaku nuk përgjigjet për detyrimet e shoqërisë “MM EUROPE ” SHPK dhe mbulon personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara prej tij.

KREU II

Kapitali i Regjistruar dhe Kuotat, Zmadhimi dhe Zvogëlimi i Kapitalit, Kalimi i Kuotave të Kapitalit

NENI 8

Kapitali i Shoqërisë dhe Kuotat

8.1 Kapitali i regjistruar i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar “MM EUROPE” SHPK është 100.000 Lekë (nje qind mije lek).

8.2.1. Ortaket themelues:

Z. GIULIO MADARO, atësia Nicola lindur ne Gioia Del Colle (BA) itali më 05/02/1972 me numer identifikimi YB2762868, zoterues i I (një) kuote me vlerë të përgjithshme 50.000 LEK, (pesedhete mije lek) që përben 50% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

PIERPAOLO MADARO, atësia Nicola lindur ne Gioia Del Colle (BA) itali më 22/12/1967 me numer identifikimi AY5277873, zoterues i I (një) kuote me vlerë të përgjithshme 50.000 LEK, (pese dhjete mije lek) që përben 50% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Kapitali i nënshkruar dhe i shlyer plotësisht nga ortakët e shoqërisë.

NENI 9

Zmadhimi dhe Zvogëlimi i Kapitalit të Regjistruar



9.1 Kapitali i regjistruar i shoqërisë mund të zmadhohet pa kufi, një ose disa herë, me vendim të Ortakut të Vetëm, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

9.2 Kapitali i regjistruar i shoqërisë mund të zvogëlohet me vendim të Ortakut të Vetëm. Në çdo rast, kapitali i regjistruar i shoqërisë nuk mund të zvogëlohet nën minimumin e kërkuar nga ligji.

NENI 10

Kalimi i Kuotave të Kapitalit të Regjistruar

10.1 Kuota e kapitalit është lirisht e transferueshme.

10.2 Kalimi i kuotës bëhet me vendim të Ortakut të Vetëm ose edhe vetëm nëpërmjet nënshkrimit të kontratës së shitjes së kuotës, pa qenë nevoja e marrjes së një vendimi paraprak nga Ortaku i Vetëm i shoqërisë.

10.3 Kuota mund të pjesëtohet për shkak të kalimit.

10.4 Kuota e kapitalit është lirisht e transferueshme në rrugë trashëgimie.

KREU III

Organet e Shoqërisë, Punësimet në Shoqëri

NENI 11

Asambleja e Përgjithshme

(Ortaku i Vetëm)

11.1 Organi vendimmarrës i shoqërisë është Asambleja e Përgjithshme (Ortaku i Vetëm).

NENI 12

Të Drejtat dhe Detyrimet e Asamblesë së Përgjithshme (Ortakut të Vetëm)

12.1 Asambleja e Përgjithshme (Ortaku i Vetëm) merr vendime për shoqërinë në lidhje me çështjet e mëposhtme:

- përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- ndryshimet e statutit;
- emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- emërimin dhe shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të regjistruar;
- përcaktimin e shpërblimeve, për administratorët, likuiduesit dhe ekspertët kontabël të regjistruar;
- mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshi përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- pjesëtimin e kuotës;
- përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;

- riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- vendos për pagat e punonjësve dhe dhënien e shpërblimeve përkatëse;
- të gjitha çështjet e tjera të cilat parashikohen në ligji dhe nuk i janë deleguar Administratorit të Shoqërisë.

NENI 13

Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme (Ortaku të Vetëm)

13.1 Për thirrjen dhe mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme (Ortakut të Vetëm) do të zbatohen dispozitat ligjore në fuqi dhe konkretisht Ligji Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

13.2 Vendimet e marra nga Ortaku i Vetëm, së bashku me procesverbalin e mbledhjes dhe aktet e tjera që i bashkëlidhen sipas ligjit këtij procesverbalit, regjistrohen në librin e shoqërisë.

NENI 14

Administratori

14.1 Administratori është organi ekzekutiv i shoqërisë.


14.2 Shoqëria administrohet nga një administrator që emërohet dhe shkarkohet nga Asambleja e Përgjithshme. Afati i emërimit është 5 vjet me të drejtë ripërtëritje.

14.3 Administratori ka të drejtë të kryejë administrimin e zakonshëm të shoqërisë. Ai ka të drejtë të:

- përfaqësojë shoqërinë pranë çdo organi shtetëror si dhe në marrëdhënie me të tretët;
- të hartojë dhe të nënshkruajë çdo dokument të nevojshëm lidhur me mbarëvajtjen e aktivitetit të shoqërisë si dhe ti depozitojë ato pranë çdo organi kompetent shtetëror, apo personave të tretë privatë, në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.
- të kujdeset për mbarëvajtjen e punëve të përditshme të shoqërisë, duke kryer të gjitha veprimet e nevojshme lidhur me mbikëqyrjen e personelit, punësimin dhe pushimet nga puna të personelit;
- të kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- të përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- të krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- të kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- të kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

14.4 Administratori i shoqërisë do të jetë **MADARO GIULIO**, atësia Nicola, nenshtetas Italian, lindur ne Gioia Del Colle date 05.02.1972 vend banimi ne MONOPOLI-ITALY, Rr Vittorio Veneto, 297, nenshtetas italian numer pasaporte YB2762868 skadence date 28/03/2028, me një afat 5 vjet me të drejtë ripërtëritje.

Specimeni i nënshkrimit te administratorit:

GIULIO MADARO


NENI 15

Punësimet në shoqëri

15.1 Për punonjësit që do të punësohen në Shoqëri, marrëdhëniet e punës midis Shoqërisë dhe këtyre punonjësve, do të rregullohen nëpërmjet kontratës së punës.

15.2 Shoqëria merr përsipër të derdhë në kohën e duhur të gjitha detyrimet ligjore dhe për të punësuarit të bëjë sigurimin e tyre në organet kompetente duke derdhur edhe përqindjen e kontributeve përkatëse sipas dispozitave ligjore në fuqi.

KREU IV

Viti Financiar dhe Bilanci Vjetor, Shpërndarja e Fitimeve

NENI 16

Viti Financiar dhe Bilanci Vjetor

16.1 Viti financiar fillon më 1 janar dhe mbaron më 31 dhjetor.

16.2 Bilanci vjetor, inventari, raporti i ecurisë së veprimtarisë dhe raporti i ekspertit kontabël të regjistruar, miratohen nga Asambleja e Përgjithshme (Ortaku i Vetëm).

NENI 17

Shpërndarja e Fitimeve

17.1 Ortaku i Vetëm ka të drejtë të marrë pjesën e fitimit të deklaruar në pasqyrat financiare të shoqërisë.

17.2 Shoqëria mund të shpërndajë fitime vetëm nëse pas pagimit të dividendëve:

- aktivet e shoqërisë mbulojnë tërësisht detyrimet e saj;
- shoqëria ka aktive likuide të mjaftueshme për të shlyer detyrimet që bëhen të kërkueshme brenda 12 muajve në vazhdim.

KREU V

Riorganizimi i Shoqërisë, Prishja dhe Likuidimi i Shoqërisë

NENI 18

Riorganizimi i Shoqërisë



18.1 Shoqëria mund të riorganizohet nëpërmjet bashkimit me një shoqëri tjetër, ose nëpërmjet ndarjes në dy apo më shumë shoqëri të tjera ose nëpërmjet shndërrimit të formës ligjore.

18.2 Riorganizimi i shoqërisë mund të bëhet vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme (Ortakut të Vetëm).

NENI 19

Prishja dhe Likuidimi i Shoqërisë

19.1 Shoqëria priset në rastet e parashikuara nga ligji ose me vendim të Asamblesë së Përgjithshme (Ortaku të Vetëm).

Në rast prishje shoqëria do t'i nënshtrohet procedurës së likuidimit.

19.2 Për procedurën e likuidimit të Shoqërisë do të aplikohet legjislacioni shqiptar në fuqi.


NENI 20

20.1 Për sa nuk është parashikuar në këtë Statut do të aplikohen dispozitat e Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" (i ndryshuar), Kodit Civil dhe legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë.


Ky Statut hartohet dhe nënshkruhet në 3 (tre) origjinale në gjuhën shqipe, të gjitha me të njëjtën vlerë ligjore. Një origjinale qëndron në dokumentacionin bazë të Shoqërisë.

ORTAKËT E SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

MADARO GIULIO

GIULIO MADARO


MADARO PIERPAOLO

Pierpaolo Madaro


Tiranë 04.11.2022